



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2019:170950

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06012293

C.nr.568/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Zenel Tasholli, në çështjen juridike të paditësit B.S..nga fsh. B., K. L.. të cilin e përfaqëson av.Gazmend Sopa me seli në Lipjan, kundër të paditurve K..M., D..M., Zh..M..dhe M..M., për vërtetimin e pronësisë mbi bazën e posedimit, më datë 02.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura kontestimore në këtë çështje juridiko – civile të paditësit B. S.nga fsh. Banullë, K. Lipjan, kundër të paditurve K.. M..D.. M., Zh.. M..dhe M.M..për vërtetimin e pronësisë mbi bazën e posedimit, për shkak të vdekjes së të paditurve K.. M., D.. Mihajlovic dhe Zhi.. M...

Procedura e ndërprerë do të vazhdoj kur trashëgimtarët e të ndjerit e marrin përsipër procedurën.

A r s y e t i m i

Paditësi B..S..nga fsh. B., K. Lipjan, në këtë gjykatë ka parashtruar padi më dt.14.12.2017, kundër të paditurve K.. M..D.. M., Zh.. M..dhe M.M., për vërtetimin e pronësisë mbi bazën e posedimit.

Gjykata ka zhvilluar fazën e shqyrtimit gjyqësor në afatet e rregullta ligjore, me ç’rast në seancën e dt. 12.03.2020, gjykata është njoftuar me certifikatën e vdekjes me numër serik V 1..., i dt. 11.04.2019, me të cilën vërtetohet se i padituri i dytë D. M.. ka vdekur më dt. 25.06.2017, si dhe me certifikatën e vdekjes me numër 03029 të dt. 11.04.1996 me të cilën vërtetohet fakti se i padituri i tretë Zh..M.. ka vdekur më dt. 10.04.1996, ndërsa me parashtrësën e dt. 24.10.2022, gjykata është njoftuar me certifikatën e vdekjes me numër serik V 10336884, e dt. 25.06.2020, nga e cila vërtetohet se i padituri i parë K.. M.. ka vdekur më dt. 30.05.2016.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277, pika a), të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.568/17, datë 02.08.2024

GJYQTARI
Zenel Tasholli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.